

sipër ecte i drobitur në bulevard nuk është në gjendje ti përgjigjet por qeveritarët ama PO.

Për Europën, integrimi i Shqipërisë është një proces i vetëkuptueshëm, i nevojshëm, i mirëpritur, sepse në Evropë motoja e mendimit dhe e veprimit është « Bashkimi bën fuqinë », një Evropë e fortë është një familje e fortë, me bij dhe bija të denjë, të mbarë e të përkushtuar. Bija Shqipëri nuk mund të ndahet nga familja, nuk mund të jetë e padenjë e mbrapshtë e plangprishëse. Përndryshe vuan Shqipëria, vuan Evropa.

Por që Shqipëria të integrohet në gjuhën e politikës do të thotë:

Shqipëria duhet të sigurojë vetë dhe jo t'ia sjellin të tjerët një sistem politik-demokratik dhe të qëndrueshëm, të vendosur në mënyrë të palëkundshme mbi një sistem zgjedhesh të lira dhe të drejta;

një qeverisje të pastër nga korrupsioni, batakillëku, arbitrariteti dhe lidhjet me

krimin; një mjedis shoqëror dhe politik të çliruar nga krimi i organizuar dhe trafiket, një mjedis ekonomik dhe juridik të mbështetur fort në parimet e shtetit ligjor, në konkurrencën e lirë, në elemi-nimin e monopoleve dhe diskriminimit. Të gjitha këto Shqipëria mund dhe duhet t'i realizojë që të ndërrojë integrimin. Të gjitha këto Shqipëria do t'i realizojë sapo timonit të qeverisë t'i vishet pak seriozitet europian, pak përgjegjshmëri europiane, pak devotshmëri europiane, pak demoraci europiane. Shqipërisë i duhet ende europianizëm që të integrohet.

Jo rastësisht egziston thënia që : nëse do të vlerësosh demokracinë e një vendi, përparimin e një shteti dhe civilizimin e një shoqërie, shiko se çfarë vendi ka gruaja në to. Prandaj integrimi në BE do të thotë për gruan që në një shtet real demokratik dhe në një shtet ligjor ajo ta ndjejë veten edhe më të mbrojtur nga ligji, edhe më të lirë në zgjedhjet e saj, duke mos vuajtur diskriminimin dhe dhunën dhe duke marrë më tepër respekt ndaj vetes.

Në një vend të zhvilluar ekonomikisht me standartet e BE, gruaja do të ketë më tepër akses për punën, më tepër të ardhura, dhe

kështu duke qenë e fuqizuar ekonomikisht, gruaja bëhet më e pavarur dhe është e aftë të rrisë kapacitetin e saj profesional, të marrë pjesë më aktive në aktivitetet publike dhe politike. Njëherazi në këtë aspekt do të ndihmojnë edhe shërbimet sociale, të cilat do të shtohen. Në një shoqëri e cila është me e civilizuar dhe e ndërgjegjësuar mbi barazinë gjinore, gratë do ta kenë më të lehtë integrimin gjinor, sepse shoqëria shqiptare ka kuptuar mbi vlerat dhe kapacitetet e grave, mbi rëndësinë e vënies në efikasitet të asaj pjese të popullsisë që përfaqëson shifrën rreth 52% të saj.

Në një vend të integruar në BE do të ketë më shumë gra në të gjitha nivelet e vendim-marrjes, si rezultat i ndërgjegjësimit publik për vlerat e grave si dhe plotësimin e kushteve të vendosura edhe nga organizmat ndërkombëtare. Kjo do të ofronte më shumë programe të cilat u japin zgjidhje problemeve të familjes, të grave dhe të fëmijëve.

Duke ditur se barazia gjinore është një domosdoshmëri për zhvillimin e një shoqërie demokratike, kur Shqipëria do të jetë anëtare e BE, kjo barazi do të jetë e mundëshme dhe

NJË ANALIZË E POLITIKËS SHQIPTARE PËR INTEGRIM

“POLITIKANË” në Shqipëri ka mjaft, por ajo që na duhet është të dish të menaxhosh politikën në mënyrë efektive, duke sjellë një proces të mirë politik. Kjo, është ajo çka fitohet bindshëm tek NDI. Nuk jemi më në kohën e Qeverisë Ahmetjane ku detyra kryesore ishte: Sigurimi i furnizimit të popullit dhe garantimin e programit të ndihmave ushqimore për të kaluar dimrin. Progresi nuk vjen vetëm nëpërmjet ndihmës ekonomike apo falë bujarisë së diasporës. Madje as koha kur gjithë krenaria shqiptare dhe ndjenja patriotike u transformua në një rrugë të vetëmohimit, të paditur dhe të pasigurt, drejt kurbetit, kur ministri i jashtëm italian Xhani de Mikeles vizitonte Shqipërinë në kuadër të bashkëpunimit dhe me foddullizëm ndër të tjera pyeste: “...a do të ketë më dyndje klandestinësh?”, dhe në fund bashkëpunimi haste vështirësi të cilat bëheshin pengesa për bashkëpunim.

Tashmë ne nuk kemi nevojë për të ndërtuar mure apo për të zburuar fasada, por nevojë për të ngritur ura. Tashmë jo vetëm ne duam të hyjmë në Evropë por edhe Evropa na kërkon dhe

jo nëpërmjet “humanizmit” apo “miqësisë së ndërtuar” por mbi baza interesash politike, ekonomike apo kulturore. Shqipëria është prezantuar tani mes studentësh dhe specialistëve që kanë shkuar në lindje e perëndim, përmes letërsisë e kulturës, grupeve artistike e sportive, nëpërmjet të cilëve është parë se Shqipëria nuk është vendi i bunkerëve, por vendi ku ka sipërmarrës të suksesshëm, projektues e historianë arkeologë e ndërtues të niveleve botërore etj.

Për një proces të mirë politik është mjaft e rëndësishme të njohësh konceptin “zhvillim”. Ky koncept përmban më tepër se një rritje ekonomike. Për më tej janë rregullatorët politikë, socialë, legjislativë dhe institucionalë ku kultura apo elementë më të paprekshëm kërkojnë më tepër kohë për ndryshim. Kjo kërkon një obligim maksimal të politikës shqiptare duke investuar në mënyrë intensive në drejtim të integritit. Rritja e transparencës është një ndërmarje publikimi e vizionit të këtij procesi, duke tejçuar më tej një rritje të besueshmërisë të elektoriatit kundrejt partisë së madhe për rastin që unë përfaqësoj. Gjithashtu bëhet edhe një faktor homogjen i zvogëlimit të asaj çka ne e quajmë fatalitet të pashma-ngshëm



ELISABETA KATIAJ,

Anëtare e KD së PS - Tiranë

në çdo parti, në çdo komb, në çdo kulturë ...KORRUPSION.

Jemi para një fakti ku grindjet politike po emetojnë një klimë krizash, të cilat nxjerrin pengesa të mëdha në bizneset shqiptare, duke krijuar kështu një rrisik josistematik, riskun politik, i cili largon investitorët e huaj dhe vendas, gjë, që bie në kundërshtim me objektivin e rritjes së investimeve në vend. Mendoj se kjo klimë politike është një nga shkaqet kryesore të vonësës për përfshirjen e Shqipërisë në BE. Stabiliteti politik e përfaqëson

vijon...

një vend më tepër se zhvillimet arkeologjike, kulturore, sportive...

Një bashkëpunim jo vetëm brenda partisë, që e konsideroj të detyrueshëm, por edhe i të gjitha partive, është një nismë e pajtimit që i qëndron logjikës për një të nesërme që na kërkon ndryshe. Nga bashkëpunimi nuk humbet askush, nga përçarja humb elektorati, humb kombi, Shqipëria. Kjo nismë do të shuante tensionet politike të vendit, ashtu si do të ndihmonte në rivendosjen e paqes

sociale. Tashmë rruga e integritit të Shqipërisë është e qartë vetëm nëpërmjet një angazhimi fisnik dhe zemërgjerë nga të gjitha palët.

Rruga e përparimit e nisur nga socialistët është orientuar drejt integritit dhe në forcimin e ekonomisë në zhvillim, duke ndikuar në zvogëlimin e varfërisë dhe rritjen e mirëqenies pra duke përmirësuar standartet e jetesës, duke krijuar një ambjent të ri ekonomik me një rritje të qëndrueshme dhe tregues të

stabilizuar, duke krijuar një konsolidim të reformave të kryera me qëllim që efekti i tyre të jetë i ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të vendit, në procesin e privatizimit, në thëllimin e parimit të konkurrencës së ndershme, në një tregëti me rregulla të ndershme loje, duke rritur produktivitetin dhe efektivitetin, duke nxitur prodhimin vendas dhe duke mbrojtur industrinë e reja të sapo krijuara, si dhe për një kombinim eficient të interesave të ekonomisë kombëtare me angazhimet ambicioze të politikës

SFIDA E INTEGRIMIT DHE REALITETI SHQIPTAR

ROLAND ÇELMETA, Anëtar i KD të PS - Tiranë

Kohët e fundit, integrimi, ky proces i dëshiruar por edhe i përfolur prej të gjithë shqiptarëve është një nga temat kryesore të diskutimit në monotoninë e jetës politike shoqërore e kulturore shqiptare.

Ç'është për ne integrimi, si e gjojmë ne këtë çështje dhe sa kontribuojmë ne për secilën pjesë përbërëse të tij? Është e qartë që secili prej nesh në vetvete është sa i vetdijshëm aq edhe entuziast për nevojën e këtij akti kaq themelor dhe historik për të ardhmen e Shqipërisë. Jam mëse i sigurtë se nëse mbahet një referendum mbarëkombëtar për integrimin në BE, shumica dërrmuese e shqiptarëve do të votojnë pozitivisht. Kjo do të dëshmojë edhe një herë aspiratat e shoqërisë shqiptare dhe të kombit shqiptar për të qënë pjesë e kësaj familje të madhe.

Nëse secili nga ne dëshiron një mrekulli të tillë doja të dija se cili është kontributi që mund të jap për këtë çështje. Si reflektohet tek secili nga ne i gjithë ky proces, i cili pas shumë përpjekjesh që e kanë zanafillën tek marrëdhëniet e para Shqipëri-BE, u kurorëzua me marrëveshjen e stabilizim-asocimit më 31 janar, 2003?

Përveç këtij fakti, pyes veten nëse në një të ardhme të afërt ne do të jemi pjesë e BE-së, çfarë do të ndodhë me Shqipërinë? A do të jetë ajo vallë e denjë që pasi të ketë fituar betejën e integritit zyrtar në BE, t'i bëjë ballë një tjetër betejë asaj të integritit real. Pra, me fjalë të tjera nuk është e vështirë vetëm të bëhesh pjesë e BE por edhe t'a mbash me dinjitet këtë titull, sepse asnjë nga ne nuk dëshiron që ne të krahasohemi me një lagje periferike

EVROPIANE ku çdo bashkëqytetar ynë evropian të mendohet mirë para se të shkelë? Pra një nga pikat më të rëndësishme të këtij synimi mbetet beteja e mirëfilltë për arritjen e këtyre standarteve sa me plotësisht.

Pra, më duhet t'i kthehem këtyre standarteve dhe të bëj një analizë të tyre duke u përballur me një realitet që vetë shoqëria shqiptare na ofron. Ky realitet nuk është gjë tjetër veçse një paralelizëm midis asaj që po ndodh aktualisht në Shqipëri dhe vetë procesit të stabilizim-asocimit, i cili prezantohet me anë të MSA. A është në gjëndje shoqëria shqiptare t'a perceptojë siç duhet këtë proces? Si duhet perceptuar faktori kohë në këtë proces? Të gjitha këto pyetje që secili nga ne i bën çdo ditë, duhet të marrin sa më shpejt një përgjigje e cila detyrimisht duhet të jetë pozitive.

Për të arritur një gjë të tillë, MSA duhet të ketë një jehonë sa më të gjerë në shoqërinë shqiptare në mënyrë që të kuptohet sa më saktë nga kjo e fundit me gjithë rreziqet dhe avantazhet që ajo ka. Kuptimi i saktë i MSA është parakusht i panegociueshëm për mbarëvajtjen e suksesshme të procesit të zbatimit të saj. Për mendimin tim përcuesit kryesorë të këtij procesi janë padyshim përfaqësuesit politikë të shoqërisë shqiptare të cilët janë dhe aktorët kryesorë të DIALOGUT POLITIK, njërës prej shtyllave kryesore mbi të cilat qëndron MSA.

DIALOGU POLITIK, gjatë periudhës së tranzicionit ka qënë një nga pikat nevralgjike të politikës shqiptare. Nga ana tjetër, ky është edhe motorri i këtij procesi. Rrjedhimisht klima jo e qartë



politike ka një influencë direkte mbi të gjithë procesin e integritit dhe zbatimit e shtyllave bazë të MSA. Pra mungesa e vullnetit politik (dhe jo vetëm) është një goditje shumë e rëndë mbi procesin dhe për vetë shoqërinë shqiptare. Ky problem duket se i ka rrënjët thellë në histori, atëherë kur e keqja më e madhe ishte përçarja e faktorit politik shqiptar në lidhje me sfidat e përbashkëta kombëtare.

Jo rrallë kemi dëgjuar të thuhet se "E KEQJA" e ka zanafillën tek ne dhe jo diku tjetër. Kjo do të thotë se gjithçka varet nga shoqëria shqiptare ose më saktë nga elita politike që e përfaqëson atë. Flitet edhe për një mospjesmarrjes të shoqërisë shqiptare në jetën politike të vendit. Kjo tregohet qartë edhe nga përqindja e ulët e pjesmarrjes së popullsisë me të drejtë vote në zgjedhjet e fundit parlamentare. A është në të vërtetë kjo rrjedhojë e mungesës së kulturës civile shqiptare apo reagim i shoqërisë shqiptare ndaj klimës së nxehtë jo stabile politike që ofron klasa e saj politike? Unë mendoj se është e dyta.

Angazhimi i shoqërisë civile në mbarëvajtjen e dialogut politik varet direkt nga roli i klasës politike në skenën mbarëkombëtare ku qëllimi kryesor tashmë dihet dhe është më i shenjtë se çdo çështje tjetër.

Pra në konkluzion potenciali intelektual integruar akoma nuk e ka treguar vlerën e tij të vërtetë, dhe kjo duhet të ndodhë për sa kohë dyert e integritit janë të hapura.

INTEGRIMI I SHQIPËRISË, SFIDA E GJITHË SHQIPTARËVE

Edhe pse kanë kaluar jo pak, por afërsisht një vit e gjysëm, nga dita e shumëpritur nga të gjithë shqiptarët, 31 Janari 2003 kur zyrtarisht në Tiranë hapen negociatat për marrëveshjen e Stabilizim dhe Asociimit me Institucionet e Bashkimit Europian, Shqipëria akoma nuk ka gjetur veten dhe nuk ka arritur të plotësojë në nivelin dhe masën e kërkuar kushtet dhe rekomandimet në Raportet paraardhëse të grupit të Task Forcës Konsultative.

Raunde të shumta bisedimesh bilaterale, premtime dhe vërejtje, angazhime dhe rekomandime, dëshirë dhe apati, demagogji dhe realitet dhe në fund zhgënjim, ose si i thonë shqip «një hap përpara dhe dy hapa prapa». Akuza dhe kundër akuza, përgjegjësi dhe papërgjegjshmëri, angazhime dhe sabotime, këto janë termat dhe fjalori i «civilizuar» politik në arenën e politikës shqiptare.

E vërteta është e vërtetë dhe ajo duhet thënë ashtu sikur se është. Ajo duhet të shërbejë për të reflektuar dhe rritur ritmin e reformave dhe standarteve europiane dhe jo për të nxitur apo krijuar konflikte artificiale për kredo politike të caktuara në shërbim të një individi apo subjekti politik. Realisht, vetëm një numër i caktuar i rekomandimeve të Raportit Për Procesin e Stabilizim asociimit janë zbatuar plotësisht, të tjerat..., së shpejti.

Duke pasur parasysh realitetin politik në vend dhe ecurinë e reformave, nevojitet angazhim politik dhe vendosmëri për të trajtuar me profesionalizëm dhe në kohë problemet e pazgjidhura si e vetmja mënyrë dhe kusht i drejtpërdrejtë për një integrim sa më të shpejtë dhe të merituar në familjen e madhe europiane.

Duke ndjekur me vëmendje si qytetar, por edhe si politikan i ri në moshë dhe karrierë, mendoj se lufta me efikasitet e strukturave kompetente të shtetit në:

- Luftë kundë krimin të organizuar, trafikëve dhe korrupsionit në të gjitha nivelet
- Reformat në sistemin gjyqsor dhe forcimi i administratës publike
- Ruajtja dhe konsolidimi i stabilitetit politik
- Respektimi i të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.
- Lufta kundër kondrbandës dhe evazionit fiskal.

• Lufta kundër ekonomisë informale dhe monopoleve, si dhe garantimi i një konkurence të lirë dhe të ndershme.

• Përmirësimi i Kodit Zgjedhor etj,

Të gjitha këto, përbëjnë elementet më të rëndësishëm dhe sfidën e radhës të strukturave të shtetit shqiptar. Vlen të thuhet që edhe pse ka arritje të dukshme në shumë nga këta sektorë, akoma dhe më shumë duhet bërë në të ardhmen.

Edhe pse, procesi i Stabilizim - Asociimit, është më tepër një proces politik dhe mbarë shqiptar, mendoj se një vend më të rëndësishëm duhet të ketë mendimi dhe kontributi i shoqërisë civile, akademikëve dhe personaliteteve të njohura të të gjithë fushave. Më shumë se emocionet politike, ky proces ka nevojë për pjekuri dhe përgjeshmëri profesionale, intelektuale dhe shoqërore.

Klima e rënduar politike ka ndikuar jo pak në ecurinë dhe kryerjen e reformave të thella. Stabiliteti i brishtë i arritur herë pas here që nga viti 2000 e në vazhdim, nuk ka mundur të garantojë atë klimë shumë të pritshme jo vetëm nga faktori shqiptar por edhe nga ata ndërkombëtarë. Tensionet e shpeshta në gjirin e mazhorancës, janë pasuar me tensione po aq të mëdha dhe një klimë të nxehtë politike edhe në marrëdhëniet ndërmjet dy forcave të mëdha politike në vend. Zhvendosja e vëmendjes ndaj reformave dhe kushteve të vendosura nga BE, janë zëvendësuar rëndom me «reforma» anarkike dhe primitive në luftën pa kriter për pushtet dhe interesa personale të aktorëve dhe subjekteve politike të caktuar në Shqipëri.

Është për t'u përsëritur që në të gjithë programet e qeverive socialiste, prioritet ka qenë dhe është nënshkrimi (mbyllja në kohë) i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, por përsëri fatkeqësisht Shqipëria ka ngelur disa hapa prapa.

Lufta kundër krimin dhe korrupsionit, trafikëve dhe kondrbandës, ekonomisë informale dhe monopoleve, nuk bëhen dhe nuk mund të bëhen me fushata sporadike apo me show mediatic, por me një strategji të qartë dhe njerëz të përkushtuar profesionalisht. Ajo çfarë i nevojitet më shumë Shqipërisë në këto çaste është një integrim i të gjithë faktorëve politikë dhe intelektualë në Shqipëri,



Nga BLEDAR DORACAJ,
Sekretar i Përgjithshëm i FRESSh

brenda njëri tjetrit.

Stabiliteti rajonal përbën një tjetër moment të rëndësishëm, kusht i domosdoshëm për përmbushjen e objektivave të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Shqipëria gjatë viteve të fundit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për stabilitet dhe bashkëjetese në rajon, duke zënë një vend mjaft të rëndësishëm dhe vendimtar për paqen dhe stabilitetin në gadishullin tonë. Së bashku me procedurat dhe kushtet e vendosura për të realizuar të gjithë reformat e nevojshme në kohë dhe cilësi, anëtarësimi në NATO, përbën testin përfundimtar dhe më të rëndësishëm që i paraprin anëtarësimin në BE.

E ndërsa asistencë dhe bashkëpunimi me faktorë dhe aktorë ndërkombëtarë është në nivele të kënaqshme, atmosfera brenda në Shqipëri është mbytëse. Mosmarrëveshjet për shumë nga elementët përbërës të Procesit, kanë krijuar dhe krijojnë një tension të panevojshëm politik.

Integrimi i Shqipërisë në BE nuk është çështje konceptesh, hamendjesh apo alternativash, por është një proces reformash të thella në përmbushjen e standarteve të Komunitetit Europian. Ai nuk është pronë e ndokujt, i cili mund ta përdorë në të mirë të vet apo të një grupi njerëzish, ai është vullnet dhe aspiratë e madhe e të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë.

Të gjithë së bashku, në mënyrë sa më modeste, të kontribuojmë me të gjitha energjitë dhe kapacitetet, duke dhënë kështu një realitet ndryshe, duke ushtruar në mënyrë koherente të gjithë presionin e nevojshëm përpara strukturave të shtetit dhe partive politike se Integrimi i Shqipërisë nuk është 'delja e zezë', por është proces në të mirë dhe shërbim të

EUROPA DHE SHQIPTARËT E SË NESËRMES

1.

Në raport me pritshmërinë për antarësimin europian shqiptarët mund të klasifikohen në europesimistë dhe naivë. Fillimi i këtij shekulli me sa duket do të kalojë duke ju gëzuar hapjes së negociatave, nënshkrimit të marrëveshjeve të njëpasnjëshme, plotësimin të standarteve pa fund dhe (dashhtë zoti) antarësimin në Bashkimin Europian. Duke qenë se gjeografikisht i përkasim kontinentit europian, antarësimi në union duket si fati ynë i paracaktuar në epokën kur termi gjeo-politikë është fjala e ditës.

2.

Bashkimi Europian është një univers në ndryshim. I ngjan një treni i cili nuk ka një itinerar të përcaktuar, por që në çdo stacion vendos mbi destinacionin e radhës. Sot shqiptarët do të përsonin një trans kolektiv nga komunikimi i lajmit se nënshkrimi i marrëveshjes për antarësim është në prag dhe (le t'i lejojmë vetes një çast ëndërrimi) sikur të votohej sot do të shpreheshin 99.99 përqind në favor të antarësimin. Në fakt votimi do të ngjasë pas dhjetë vjetësh, atëherë kur një tren i tillë do të ketë pësuar ndryshime rrënjësore sepse sfidat e reja dhe të bartura të Europës së sotme nuk janë të pakta. Një Irak i dytë mund të thellojë divergjencat, antarët e rinj mund të çënojnë ekuilibrat e forcave, rënia e

standartit ekonomik që do të pasojë zgjerimin mund të shkaktojë pakënaqësi në rritje dhe lista e frazave që nisin me “mund” është e gjatë.

E parë nën një tjetër këndvështrim, nuk ka asnjë siguri që edhe pas dhjetë vjetësh bota do të vazhdojë të dominohet nga gjeo-politika. Sot zgjidhja e preferuar për problemet e shqiptarëve është antarësimi në Bashkimin Europian. Ndërkaq pas shumë vitesh zgjidhja mund të jetë antarësimi në një union me vendet e Lindjes së Largme apo me vendet e kontinentit amerikan. Për më tepër, në se sot unionet shihen si bashkime “të përjetshme”, nesër gjithcka mund të bazohet tek aleancat fluide midis shteteve të cilat bashkohen në funksion të arritjes së interesave dhe objektivave të caktuara, për t'u shpërndarë më pas. Vendi i cili ka patur progresin më të spikatur në këto shekujt e fundit – Shtetet e Bashkuara të Amerikës – ka operuar pikërisht sipas këtij parimi. Megjithë pjesëmarrjen në NATO (zgjerimi i së cilës po pasohet nga një dobësimin i vazhdueshëm), SHBA-të nuk duket të kenë aleatë të përjetshëm, por sikurse u shpreh një ish-president vetëm interesa të përjetshme.

Gjeo-politika sfidohet jo vetëm nga e kaluara por edhe nga e ardhmja. Lehtësitet në komunikim të cilat përsosin me shpejtësi të pabesueshme do të përcaktojnë tranzicionin nga gjeo-politika drejt politikës në distancë dhe ndoshta drejt e-politikës. Përshkallëzimi ngjan tejet llogjik dhe i thjeshtë: duke qenë se sot janë mundësitë e shkollimit në distancë, pagimit të taksave në distancë, votimit në distancë, etj. përse të mos hidhet edhe hapi i qeverisjes së plotë në distancë? Në këtë mënyrë, koncepti i shtetit mund të pësojë ndryshime thelbësore deri në krijimin e shteteve virtuale të cilët kanë të gjithë karakteristikat e shtetit, me përjashtim të një territori me të cilin identifikohen. Si fillesa të shteteve virtuale do të shërbenin perandoritë financiare të cilat janë aktualisht më të


fuqishme se shtete të vecantë duke patur shumë nga elementët e shtetit në strukturat e veta. Po kështu do të nevojiteshin përpjekje gjithnjë e më të ashpra në luftën kundër terrorizmit që të parandalohet kthimi i organizatave të sotme terroriste në shtete virtuale të së nesërme.

3.

Edhe shqiptari më optimist është i bindur se rruga e Shqipërisë për në Europë do të jetë e gjatë. Përballemi me një Europë skeptike e cila ende nuk po vendos të na shtrëngojë dorën si partnerë gjë të cilën e meritojmë. Nga ana tjetër, nuk e meritojmë aspak atë trajtim depersonalizues sa herë tentojmë të vizitojmë “atdheun në perspektivë”. Dikush fajëson muslimanizmin tonë (çka bëhet më e besueshme kur sheh vendet e mbetura jashtë unionit), dikush mungesën e zhvillimit, të gjithë fajësojnë politikën dhe fajësimet nuk kanë të mbaruar. Megjithatë mund të duket si qëndrim ekstrem, pakkush ka tentuar të fajësojë Europën për cka po ndodh. Në se europianët do të donin të na shihnin si pjesë të tyre, pavarësisht nga elaborimet për standartet, antarësimi i krejt Ballkanit Perëndimor ka në fund të fundit një faturë financiare që për buxhetin e unionit është e përbalueshme. Sot Ballkani ka nevojë për Europën dhe po gjen një derë të mbyllur. Nesër rolet mund të invertohen. Për shembull, Shqipëria e vitit 2015 që ka hequr “të zitë e ullrit” për të plotësuar standartet, mund të gjykojë se antarësimi në union nuk përbën më një ngjarje të dëshirueshme. Një opsion alternativ përveç aleancave në distancë do të ishte një shtet që funksionon sipas parimit të Montecarlo-s duke i ofruar multi-miliarderëve një klimë dhe një mjedis të mrekullueshëm për banim dhe lehtësira fiskale për bizneset e tyre. Nga ana tjetër nuk përjashtohet si për Shqipërinë, ashtu edhe për krejt rajonin, opsioni i shndërrimit në një pistë permanente të krimin dhe ndoshta edhe të terrorizmit ndërkombëtar cka do të sillte kosto të pallogaritshme për europianët.

4.

Në rrjetën e arsytimeve të mësipërme – një pjesë e të cilave hipotetike dhe një pjesë realiste – procesi i antarësimin mund të marrë herë trajtat e një provimi me profesorë të rreptë dhe herë trajtat e një



ERION DASHO,

Anëtar i Këshillit Kombëtar të PSD



RITMET DHE ARRITJET PËR REALIZIMIN E ASOCIIM STABILIZIMIT ME BE

FATMIR MEDIU, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian dhe Paktin e Stabilitetit

INTEGRIMI EUROPIAN është procesi më i rëndësishëm në të cilin është përfshirë vendi ynë. Shqipëria si pjesë geografike, historike dhe kulturore e Europës, nëpërmjet këtij procesi synon të jetë pjesë e familjes Europiane edhe në aspektin politik dhe institucional. Familja Europiane është një familje rregullash dhe ligjesh, standartesh të detyrueshme dhe në këtë proces Shqipëria do të rrisë standartet e saj politike, demokratike dhe ekonomike, sepse pa këto standarde ajo nuk mund t'i bashkohet BE-së.

Të gjithë duhet të kuptojmë se nuk është Bashkimi Europian që kërkon t'i bashkohet Shqipërisë, por vetë Shqipëria BE-së - e theksoj këtë për të kuptuar mënyrën sesi duhet ta perceptojmë në këtë proces. Ky është një proces që varet kryekëput nga ne shqiptarët dhe natyrisht në këtë proces ne asistohemi nga BE-ja, por në fund të fundit çdo gjë ndërvaret se, *sa dhe si*, ne zbatojmë të ashtuquajturat detyrime që vijnë nga Brukseli.

Procesi ka të nevojshem disa elemente: njohjen e tij, njohjen e vështirësive të mëdha të cilat ai bart në aspektin e riskut politik, në aspektin e vështirësive ekonomike dhe sidomos në aspektin e strukturave integruese të cilat duhet të përballojnë të gjithë makinerinë e jashtëzakonshme të funksionimit të Brukselit.

Vështirësitë shtohen për faktin se edhe vetë BE-ja është në një proces të avancimit të mënyrës së organizimit dhe funksionimit, gjë që të krijon pershtypjen se ne dhe BE-ja jemi dy vektorë afërsisht paralelë, dhe pikën e takimit nuk e kemi shumë të afërt. Të gjitha këto shtojnë rolin dhe domosdoshmërinë e konsensusit politik, të përcaktuar jo si sipërfaqësor, por të bazuar në strategji gjithëpërfshirëse për politikën dhe shoqërinë, si aktore e interesuar drejtpërdrejt në këtë proces. Jo se ai ka munguar, por përgjithësisht ka qenë i sipërfaqshëm për shkak të marrjes në konsideratë dhe njohjes së pakët të tij nga pjesë të rëndësishme të qeverisë, deri edhe nga ministra, nga parlamentarë e për më tepër nga vetë shoqëria.

Gjendjen tonë dhe ecurinë e procesit të Integrimit e jep Raporti i

Komisionit Europian për Shqipërinë për Procesin e Stabilizim Asocimit, i cili është një instrument kontrolli i drejtpërdrejtë i procesit të reformave të ndërmarra nga Shqipëria. Në këtë raport trajtohen me hollësi dhe realizëm gjendja e vendit në të gjitha aspektet politike dhe ekonomike, si dhe jepen sugjerime se ku duhet të përqëndrohet vëmendja gjatë 12 muajve të ardhshëm. Situata për Shqipërinë në këtë raport, në pjesën më të madhe paraqitet kritike dhe me shumë probleme. Mungesa e zhvillimit të reformave, sidomos në aspektin e zbatimit të tyre, korrupsioni dhe krimi i organizuar, problemet me ekonominë informale, drejtësia problematike, mos plotësimi i standarteve për zgjedhje të lira dhe të ndershme mbeten probleme të mëdha dhe shqetësuese, të cilat ngarkojnë përgjithësisht me përgjegjësi ekzekutivin, por mbeten gjithashtu, një detyrë për të gjitha institucionet, duke marrë në konsideratë edhe detyrimet përkatëse kushtetuese të këtyre institucioneve për përbushjen e detyrimeve në procesin e integrimit.

Për këtë qëllim, ky raport u vihet në dispozicion të gjithë dikastereve (nëpërmjet rrjetit të negociatorëve), duke i'u kërkuar të përgatisin studime vlerësuese sektoriale mbi problemet që ngre raportin, për të pasqyruar qartë progresin e bërë që nga publikimi i këtij raporti deri më sot, si dhe masat që janë marrë për trajtimin e problematikës që ende ekziston.

Natyrisht që ecuria e mëtejshme e procesit të integrimit pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit do të varet nga ecuria e reformave brenda vendit dhe nga shkalla në të cilën Shqipëria do të jetë në gjendje të zbatojë angazhimet e saj që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes. Mendoj se ne kemi ecur mirë me nënshkrimin e neneve gjatë negociatave për hapjen e MSA-së, dhe unë mund të përmend këtu zhvillimin e një raundi të plotë negociatash që përfshin si raundet politike dhe ato teknike. Në raundin e parë politik të diskutimeve mbi draft-marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, në objektin e diskutimit u përfshinë këto çështje: Preambula e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit; parimet e përgjithshme, Dialogu Politik; dhe bashkëpunimi Rajonal. Raundi i parë teknik i negociatave, përfshiu disa nene shumë të rëndësishme të Marrëveshjes si: Lëvizja e lirë e punonjësve, ofrimi i shërbimeve, Kapitali, etj. Në raundin e dytë teknik të negociatave për Marrëveshjen e

Stabilizim-Asocimit u shqyrtuan çështje shumë sensitive si: "Ofrimi i shërbimeve", Pagesat rrjedhëse dhe qarkullimi i kapitaleve, Përfitimi i pasurive të paluajshme nga shtetas të BE-së", etj. Në 25 qershor 2003 u zhvillua në Bruksel raundi i dytë politik gjatë të cilit u negociaua Titulli VII "Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme", (nenet 78 + 81-84 të Draft-Marrëveshjes) që ka të bëjë me forcimin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve dhe bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, pastrimit të parave, dhe veprimtarive kriminale. Megjithatë, Brukseli ka një dyshim të madh nëse ne jemi të zotët të zbatojmë ato që kemi nëshkruar dhe që kërkon MSA.

Sfida kryesore për nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asocimit mbetet përgatitja e Planit Kombëtar të Integrimit bazuar në Instrumentin e Partneritetit Europian të ofruar nga BE pas Samitit të Selanikut. Këtu duhet një vëmendje e veçantë sidomos në angazhimin e të gjithë faktorëve të rëndësishëm institucionale, siç janë Ekzekutivi dhe Parlamenti, por edhe me bashkëpunimin e faktorëve të tjerë të domosdoshëm të shoqërisë shqiptare. Detyra më konkrete politike e cila duket që do të kushtëzojë nënshkrimin e MSA do të jetë realizimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, sipas standardeve ndërkombe të. Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit është vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik të shtetit kandidat. Për t'u bërë palë e marrëveshjes, Shqipëria duhet të plotësojë kriteret e vendosura nga Këshilli Europian i Kopenhagenit në qershor të vitit 1993. Këto kriterë janë të karakterit politik dhe ekonomik. Këto kriterë kërkojnë që vendet kandidatë të garantojnë:

"Stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve",

"Ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si dhe aftësinë për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së."

"Aftësinë për të përbushur detyrimet e anëtarësimit në BE duke përfshirë aderimin për qëllime politike, ekonomike dhe monetare të bashkimit. Kjo do të thotë që vendet kandidatë duhet të adoptojnë të gjithë paketën ligjore të Be-së të njohur si "acquis communautaire".

Rëndësia e përqasjes së legjislacionit shqiptar, por edhe garantimit i zbatimit të këtij legjislacioni nëpërmjet administratës së përshtatshme,